




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. D.p. Dep.	DPKI
Nr. ftoje Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	06-1498/20
Data Datum Date	15-07-2020



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nëparag. 1.5, nenit 11 paragrafi 1, nëparag. 1.1, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit, me datë 14.07.2020, nxjerrë këtë:

**V E N D I M**

- I. Mbyllet rasti me nr. *AKK-DPKI- 06-1116/20*, për zyrtarin e lartë z. Tefik Bekteshi, Drejtor i Klinikës së Kardiokirurgjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, për shkak se është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.**
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Tefik Bekteshi, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Ky rast ka filluar të trajtohet pasi që është identifikuar se zyrtari i lartë z. Tefik Bekteshi, Drejtor i Klinikës së Kardiokirurgjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, njëkohësisht është edhe person i autorizuar në biznesin privat "Tefik Bekteshi" B.I. (Klinika për Sëmundje Kardiovaskulare "Didi").

Agjencia kundër Korrupsionit, me qëllim të verifikimit të gjendjes së konfliktit të interesit ka kërkuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK) informatat për bizneset në fjalë (shkresa zyrtare: DPKI-06-516/20). Nga informata për biznesin të cilën Agjencia kundër Korrupsionit e ka pranuar prej ARBK-së (shkresa zyrtare: DPKI-06-01/516/20), është konstatuar se zyrtari i lartë z. Tefik Bekteshi, është person i autorizuar në biznesin e sipërsëhënuar.





Agjencia kundër Korrupsionit, me shkresën zyrtare DPKI-06-1280/20, e ka njoftuar zyrtarin e lartë lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, zyrtari i lartë z. Tefik Bekteshi është njoftuar lidhur me faktet për rastin e tij, si dhe është udhëzuar për veprimet që duhet t'i ndërmerret për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të jetë person i autorizuar në biznes privat, për faktin se një situatë e tillë paraqet papajtueshmëri me ushtrimin e funksionit publik, përkatësisht gjendje të konfliktit të interesit. Kjo ndalohej me dispozitën e nenit 13, paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, ku përcaktohet se:

*“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksioni”.*

Zyrtari i lartë z. Tefik Bekteshi, është pajtuar me konstatimet e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe ka premtuar se menjëherë do të ndërmarrë veprime në mënyrë që ta shmangë gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar informatën (DPKI-1280-1/20), me të cilën dëshmohej se zyrtari i lartë ka bërë ndryshimet e nevojshme në biznese.

Pas analizimit të informatës mbi biznesin, Agjencia kundër Korrupsionit konstatoi se zyrtari i lartë z. Tefik Bekteshi, ka transferuar të drejtat e drejtimit të biznesit privat tek personi i besuar, sikurse parashihet me nenin 19 paragrafi 1, nënpar. 1.1 lidhur me nenin 15 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik. Në këtë mënyrë, Agjencia konstatoi se me veprimet që i ka ndërmarrë zyrtari i lartë, është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11, të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shqip Havolli  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

